

TRIBUNA SINDIKALE

Shtator 2007

Dhe drit' e ditorisë
përpara do na shpjerë



Vizitoni Faqen Zyrtare te FSASH/SPASH
ne Internet ne adresen:
www.fsash-spash.com

Ne te do te gjeni rubrikat :

- Nga ngjarjet dhe aktivitetet me te fundit,
- Dokumente te rendesishme te dy sindikatave si Kontrata Kolektive e Punes, Statutet dhe historikun perkates,
- Te dhena, dokumente e foto mbi punen e femijeve dhe angazhimin e sindikatave per parandalimin dhe eliminimin e saj,
- Kalendarin e aktiviteve etj.

Editorial**GEZUAR DHE SUKSESE, TE DASHUR
MESUES E NXENES**

Filli Viti i Ri shkollor 2007-2008. Me 17 shtator qindra mijera nxenes te klasave te para, te klasave me te larta te arsimit 9-vjecar te detyruar dhe te shkollave te mesme

dhe shkalle te larte kualifikimi.

Sfida me te cilen ata perballen eshte: Arsim cilesor publik dhe shanse te barabarta per te gjithë femijet shqiptare per t'u



gjallëruar perseri dorret e shkollave ne te kater anet e vendit, duke nisur, se bashku me mesuesit e tyre, betejën e re per dije e kulture.

Rreth 36 000 mesues te kualifikuar e me pervojë, por midis tyre edhe shume te rinj qe mreshohen per here te pare ne amaten e madhe te mesimdhënesve dhe edukatoreve te brezit te ri, filluan perballjen me nje vit mesimor qe kerkon angazhim e perkushtim, disipline shkencore

arsimuar.

Sindikatat e arsimit, SPASH dhe FSASH, qe jane gjeresisht te angazhuara dhe te interesuara per reformimin dhe modernizimin e arsimit, persherdësin perzaretisht, me rastin e kesaj feste te V itit te Ri shkollor, anetaret e tyre, gjithë mesuesit dhe drejtuesit e arsimit parauniversitar dhe u urojne atyre vit te riare e suksese ne detyren e tyre fisnike

PERMBAJTJA

✓ <i>Editorial:</i>	
Gezuar dhe suksese, te dashur mesues e nxenes	2
✓ Qendrim antiligjor dhe veprime vandaliste ndaj sindikatave	3
✓ Angazhim serioz per te zgjidhur problemet, sipas Kontrates Kolektive	
<i>Nga Takimi i drejtuesve te FSASH e SPASH me Ministrine Arsimit dhe Shkencës</i>	4
✓ Sindikatat mbrojne me vendosmeri mardheniet e punes te anetareve te tyre	5
✓ Tenjohim strukturen e pagave ne arsimin parauniversitar	6
✓ Mbrojtja e anetareve lidhet me zhvillimet progresive ne arsim	
<i>Nga mbledhja e KD te FSASH</i>	7
✓ Kontrata Kolektive e Punes, 2006 - 2009	8
✓ Pedagogjikasit - një brez mësuesish që meriton mirënjohje	15
✓ Te reja shkencore dhe keshilla praktike	16

*Kopertina e pare:
Vizitoni faqen zyrtare
te FSASH/SPASH ne Internet*

**TRIBUNA SINDIKALE
Nr. 29, Periodike**

Botim i FSASH dhe SPASH

Me mbështetjen financiare te Konfederates se Sindikatave te Holandes, FNV

ADRESA: Bulevardi "Zogu i Pare"

Pallati Ali Kelmendi, kati III,

Tel: 22 83 46

Tel & Fax: 25 65 32

E-mail: fsash@icc-al.org

Internet: www.fsash-spash.com

Keshilli Botues:

Xhafer Dobrush, i

Bajram Kruja,

Lumturi Mataj,

Defrim Spahiu,

Petref Çelaj,

Aleks Dushi,

Stavri Liko, Kryeredaktor

Qendrim antiligjor dhe veprime vandaliste ndaj sindikatave

Nkurrën forcërisht nga zyrat dhe u shkatërruan të gjitha materialet

Sic është bërë e njohur, Zyra e Përbërimit e Tiranës, duke përdorur dhunën policore, me 1 gusht 2007, ndërmori një goditje të rëndë ndaj selive të sindikatave qendrore, KSSH e BSPSH, ku kanë qene të vedosura edhe FSASH e SPASH.

Sindikatat, përfshirë edhe ato të ar-

simit, jo vetëm që u nxorën forcërisht nga zyrat dhe u flakën në muge, pa iu siguruar asnjë vend pune, por atyre iu dëmtua e shkatërrua edhe baza materiale dhe gjithë dokumentacioni. Si rrjedhojë, që nga 1 gushti e deri me sot, veprimtaria e FSASH e SPASH zhvillohet në kushte të jashtëzakonshme.

Përballë kësaj situatë shumë të vështirë për veprimtarinë e sindikatave të arsimit, Sekretari i Përgjithshëm i Federatës Ndërkombëtare të Arsimit Z. Fred van Leeuwen i ka drejtuar një letër Kryeministrit Sali Berisha, tekstin e së ciles po e botojmë të plotë në vijim:

Shkelqesisë së Tij,
Z. Sali Berisha
Kryeministër i Shqipërisë
Bruksel, 8 gusht 2007

I dashur Kryeministër,

Po ju shkruaj në emër të Federatës Ndërkombëtare të Arsimit, EI, Sindikates Globale që përfaqëson mësuesit dhe punonjësit e tjerë të arsimit, për të protestuar kundër nxjerrjes forcërisht nga zyrat, më datën 1 gusht 2007, të Konfederatës së Sindikatave të Shqipërisë (KSSH) dhe Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë, (BSPSH).

Mësuesit kudo në botë janë të tronditur nga lajmi se aktivitetet e këtyre dy organizatave demokratike janë ndërprerë në këtë mënyrë.

Federata Ndërkombëtare e Arsimit, EI, është vënë në dijeni se forcat e policisë hyjnë në zyrat e sindikatës në adresën Bulevardi " Zogu i parë", Pallati "Ali Kelmendi", në Tiranë dhe rrëmbyen forcërisht dokumentat dhe gjithçka në pronësi të sindikatave, disa prej të cilave, gjatë këtij procesi, u shkatërruan. Është për të ardhur keq fakti që sindikatat nuk u paralajmëruan se do të ndërmerrej një veprim i tillë dhe që stafi i tyre nuk u lejuar të hynte në ndërtesë. Ekzistojnë njoftime se sindikatat u përpoqën të kontaktonin me Qeverinë dhe me autoritet policore, ndërkohë që ndodhnin këto ngjarje, por përpjekjet e tyre ishin pa rezultat.

Federata Ndërkombëtare e Arsimit, EI, ve në dukje që autoritet shqiptare janë zotuar në të kaluarën për të gjetur zgjidhje për nevojën që kanë sindikatat për një ambient për zyrat. Në na vjen shumë keq që një zotim i tillë nuk është pëmbushur dhe shprehim shqetësimin tonë serioz që

liria e organizimit, baza e shoqërisë demokratike, mund të vihet në rrezik në vendin tuaj. Në pajtim me Konventat e Organizatës Ndërkombëtare të Punës në lidhje me lirinë për t'u organizuar, e ratifikuar nga Republika e Shqipërisë në vitin 1957, ne nxisim qeverinë tuaj të shprehë

të mund të fillojnë aktivitetin e tyre normal.

Punonjësit shqiptarë mbështeten në këto organizata për të mbrojtur interesat e tyre, për të patur kushte më të mira pune dhe, ç'është më e rëndësishme, për të punuar në bashkëpunim me Qeverinë, në



ndonjë ndërhyrje të mundshme që kufizon të drejtat dhe të marrë masat e nevojshme e të përshtatshme për të siguruar që punonjësit të mund të ushtrojnë të drejtën e tyre për t'u organizuar.

Duke marrë parasysh seriozitetin e kësaj çështjeje, Federata Ndërkombëtare e Arsimit, EI, Ju bën thirrje të ndërhyni në mënyrë të menjëhershme, në mënyrë që të bëhet e mundur që KSSH dhe BSPSH

mënyrë që të eliminojnë punën e fëmijëve dhe për të arritur synimin e Arsimit për të Gjithë.

Përpjekjet Tuaja për të siguruar që të gjendet një zgjidhje e menjëhershme për këtë problem do të vlerësoheshin shumë.

I taji shqiptar
Fred van Leeuwen
Sekretar i Përgjithshëm i EI

Angazhim serioz per te zgjidhur problemet, sipas Kontrates Kolektive

Nga Takimi i drejtuesve te FSASH e SPASH me Ministrin e Arsimit dhe Shkences

Me kerkesen e drejtuesve te dy sindikatave te arsimit, Z. Xhafer Dobrushki dhe Z. Bajram Kruja, te enjten date 6 shtator, u zhvillua nje Takim me Ministrin e Arsimit dhe Shkences zotin Genc Pollo, ku u

diskutuan probleme te rëndësishme qe kane te bejne me partneritetin social, mbrojtje te interesave social ekonomike te mesuesve dhe zhvillimin progresiv te sistemit arsimor ne vendin tone.

Ne emer te anetareve qe

perfaqesojne, drejtuesit e sindikatave e informuan Ministrin rreth veprimtarite e shumta qe ato kane organizuar e po organizojne dhe i paraqiten atij kerkesat qe vijojne:

1 PER NORMALIZIMIN E VEPRIMTARISE SE FSASH E SPASH, PAS

NXJERRJES NGA AMBJETET E PUNES DHE SHKATERRIMIT TE MJETEVE TE PUNES DHE DOKUMENTACIONIT.

Me daten 1 gusht 2007, Zyra e Përbashkimit Tirane, pa paralajmërim, me ndihmen e forcave policore dhe te mbështetur nga ish-pronaret, u futën forcerisht ne anbijentet e selive te KSSH dhe BSPSH, ku ishin edhe zyrtarë e te dy sindikatave te arsimit. Ne prezence te punonjesve te FSASH thyen me force dërran e Zyres te Federates, ndërsa dërran e Zyres se SPASH u thye pa prezencen e asujt.

Keto veprime te dhuneshme u shprehuan me shkatërrimin e tavolinave te punes, te kompjuterave dhe te te gjithë sistemit te komunikimit dhe te dokumentacionit.

Qe nga ajo kohe ne jemi ne rruge dhe nuk kemi asnje mundësi per te punuar.

Perfaqesues te administrates se Qeverise kane premtuar per nje sistemim modest me zyra te te dy Konfederatave, dhe ne kete sistemim, nese behet, seciles sindikate te arsimit nuk i takon me zyre, por ndoshta nje tavoline dhe nje karrike.

Argumenti ose pretendimi se sindikatat kane prona, nuk eshte aspekt i vertete per sindikatat e arsimit, sepse asnjera prej tyre nuk zoteron asnje prona. Disa prona qe u jane dhene sindikatave, te cilat nuk jane ne Tirane, por neper rrethe te ndryshme, i posedojne dhe administrojne vetem dy grupimet e media sindikale, pra BSPSH dhe KSSH.

Ne keto kushte, z. Minister, ne jemi luteni qe te shikoni mundësi qe te dy sindikatave tona t'u vihet ne perdorim nga nje zyre, ne nje anbijent te mundshem, me

qellim qe te rifillojne veprimtarine. Ky nuk eshte nje detyrim per MASH, por ne cob kontrate kolektive qe kemi nenshkruar, edhe ne Kontraten Kolektive te 4 korrikut 2006, Ministria angazhohet per te na ndihmuar me anbijente pune. Kjo eshte edhe nje praktike nderkonbetare.

Nese ju do te na siguron zyra, Federata nderkonbetare e Arsimit, EI, ku ne jemi anetare, dhe partnere te tjere mund te na ndihmojne per t'i pajisur ato.

2 PER PAGIMIN E DERI DYPAGAVE MESUESVE ANETARE TE SINDIKATES QE DALIN NE PENSION.

Ne cob Kontrate Kolektive te Punes qe te dy sindikatat e arsimit kane nenshkruar qe nga viti 2001 e ketej, eshte sanksionuar qe, me propozimin e te dy sindikatave qendrore, mesuesve qe dalin ne pension u japin deri ne dy paga mujore. Kjo arritje eshte perfshire ne menyre te natyreshme e ligjore edhe ne Kontraten Kolektive te Punes qe u nenshkrua me 4 korrik 2006, ne nenin 8, pika 13 te se ciles thuhet: "Me autorizimin me shkrim nga sindikatat nenshkruese te kesaj Kontrate Kolektive, mesuesit qe dalin ne pension perfitojne deri ne dy paga mujore shperblim, brenda buxhetit vjetor te planifikuar per cob njesi administrative".

Kjo praktike eshte zbatuar edhe gjate vitit 2006 e deri tani.

Mirepo me miratimin e Vendimit te Keshillit te Ministrave per Fondin e Vecante, ku, midis te tjerave, thuhet se cob punonjes, pervec 10.000 leke shperblim ne fund te vitit, nuk mund te shperblehet gjate vitit me me shume se me 1 paga mujore, kane filluar te dalin probleme per zbatimin e ketij neni te Kontrates Kolektive.

Disa Qendra Ekonomike te Bashkive dhe Komunave, qe bejne pagesat, kane filluar te refuzojne pagimin e dy pagave

per ata mesues sindikaliste qe dalin ne pension dhe qe sindikatat u japin vertetimin per kete shperblim.

Se pari, duhet te sqarojme se ne praktiken tone eshte qe sindikatat nuk i japin cob mesuesi dy paga, por kane akorduar shpesh edhe 1 paga, madje, ne raste te vecanta, edhe gjysem paga. Kjo percaktohet nga mendimi qe ka punedhenesi per kete mesues, nga mendimi qe ka sindikata e bazes, nga fondet qe ka ne dispozicion Komuna ose Bashkia, nga aktivizimi dhe kontributi i perfituesit ne zbatimin e reformimit e modernizimit te arsimit.

Se dyti, kjo e drejte e fituar per me shume se 3 vjete, eshte e garantuar me ligj, Konkretisht me Kodin e Punes, dhe nuk mund te hiqet me asnje vendim ose akt tjetër.

Se treti, dhënia e deri dy pagave per mesuesit qe dalin ne pension, nuk ka asnje lidhje me VKM per Fondin e Vecante, mbasi Vendimi per Fondin e Vecante flet per punonjes te dalluar qe vazhdojne punen dhe bejne pune cilesore, prandaj mund te shperblehen deri me nje paga, ndërsa ne rastin tone jemi para nje problemi krejt tjetër, kemi te bejne, jo me me nje punonjes, por me nje mesues qe i ka nderprere perfundimisht marrëdhëniet e punes dhe, ne vazhim, gezon vetem pensionin e pleqërisë.

Zgjidhja mund te behet me nje udhezim te perbashket te MASH, Ministrise se Financave dhe organeve qendrore te FSASH e SPASH.

3 PER ZBATIMIN E DISA NENEVE TE KONTRATES KOLEKTIVE KU DUHEN HARTUAR VKM OSE KU DUHET NJE ANGAZIM I MASH DHE DAR E ZA.

Per kerkesat qe ka neni 8/7 i Kontrates Kolektive te Punes duhet qe te dy

sindikatat qendrore, ne bashkepunim me Aparatin e MASH, te hartojne VKM te posaçme. Eshte fjala per vjetersine ne pune me 2 perqind dhe per ata mesues qe kane me shume se 25 vjet vjetersi ne pune, si edhe per shtesen per kualifikim, te cilen ta marrin jo 20, por 25 perqind.

Por ne kete pike, nje shqetsim i madh per ne eshte problemi i arketimit te kuotizacioneve me ndalesa ne bordero. Te dy sindikatat kane hartuar nje dokumentacion ne perputhje te plote me kerkesat e ligjit, konkretisht nenit 117/2 te Kodit te Punes, dhe nenit 181, pika 7, gama "c" po te ketij Kodi.

Por disa Qendra Ekonomike, dhe Kryetare Bashkish e Komunash, me pretendime absurde, aspak ligjore, nuk na kryejne veprimet per ndalimin dhe xhirimin e kutave ne llogarite tora.

Kjo praktike me disa nrethe ecan mire, por ne shume prej tyre gjejne pengesa.

Ajo qe ne kerkojne eshte: DAR dhe ZA te na ndihmojne qe Qendrat Ekonomike te Bashkive dhe Komunave te mos na pengojne, sepse kjo danton rende gjithe veprimtarine tone.

Ne kemi menduar te organizojne ne 8 qarqe takime me kryetare te bashkive dhe komunave per probleme te arsimit dhe partneritetit social me sindikatat. Per kete eshte e nevojshme qe:

- Drejtoret e DAR dhe ZA te na ndihmojne me anen e Prefekteve per organizimin e ketyre takimeve,

- Ne keto takime te marrin pjese edhe perfaqesues nga MASH, sepse problemet jane te përbashketa.

Diskutimi gjate ketij Takimi ishte konstruktiv. Ministri vleresoi punen qe kane bere dhe po bejne sindikatat e arsimit, jo vetem per mbrojtjen social ekonomike te punonjeseve, por edhe per ceshtje te tjera te zhvillimit cilesor te sistemit arsimor ne vendin tone dhe shprehu angazhimin per te zgjidhur problemet e plotesuar kerkesat e paraqitura, sipas neneve te Kontrates Kolektive te Punes.

Zoti Pollo nenvizoi, gjithashtu, nevojën per nje bashkerendim te problemeve midis DAR e ZA dhe seksioneve sindikale ne nrethe, sidomos per kualifikimin profesional dhe vleresimin e punes se mesuesve. Ai pranoi kerkesen e sindikatave qe Kontrata Kolektive e punes te zberthetet e punchet ne seminare te vecanta me drejtues te DAR e ZA dhe me drejtues e punonjes te pushtetit vendor.

Sindikatat mbrojne me vendosmeri marrëdhëniet e punes te anetareve te tyre

Majt e fundit, disa Drejtori dhe Zyra Arsimore, bene levizje dhe largime masive nga puna te mesuesve me shkolle te mesme pedagogjike ose shkolle te tjera profesionale te profilit te mesuesise dhe krijuan shqetsime serioze ne masen e mesuesve te kesaj kategorie, ne keshillat dhe Seksionet Sindikale. Veprimet qe ndemoren Drejtorite Rajonale dhe Zyrat Arsimore ne Pogradec, Devoll, Shkoder, Remet, etj., vinin ne kundërshtim te hapur me Nenin 4 te Kontrates Kolektive te Punes dhe Udhëzimit Nr. 29 date 18.09.2006 te Ministrat te Arsimit dhe Shkences "Per emerimet dhe levizjet e personelit mesimor dhe drejtues ne arsimin parauniversitar".

Ndaj ketyre veprimeve arbitrare dhe antiligjore reagon, jo vetem mesuesit e prukur padrejtesisht, por edhe Seksionet Sindikale te nrethe ku kane mbodhur keto shkelje.

FSASH dhe SPASH, ne mbështetje te Keshillave dhe Seksioneve Sindikale, qe u ngriten kunder shkeljeve ligjore qe po benin keto DAR dhe ZA ne nrethe, e shtuan problemin me force ne Ministrine e Arsimit dhe Shkences dhe kerkuan ndalimin dhe anulimin e ketyre veprimeve antiligjore dhe zbatimin me korrektesi

nga nivelet e dyta te Kontrates Kolektive te Punes.

Ne pergjigje te kerkesave te Sindikatave Qendrore, per te normalizuar gjendjen dhe korrigjuar shkeljet e verejtura ne procedurat "Per emerimet dhe levizjet e personelit mesimor dhe drejtues ne arsimin parauniversitar", Ministri i Arsimit dhe Shkences, z. Genc Pollo urohroi Drejtorine perkatese ne MASH qe te mjerre nje qarkore shpjeguese per zbatimin me korrektesi te pikës 7 te Udhëzimit Nr. 29 date 18.09.2006 dhe nenit 4 te Kontrates Kolektive te Punes te dates 4 korrik 2006.

Me qellim qe Seksionet Sindikale te njihen me shpjegimet dhe qendrimin e MASH per kuadrin ligjor ekzistues per emerimet, levizjet ne pune dhe largimet nga puna, FSASH dhe SPASH vendosen qe letren perkatese qe MASH u ka derguar DAR dhe ZA ta botojne te plote ne kete numur te revistes "Tribuna Sindikale". Me kete rast FSASH dhe SPASH garantojne anetaret qe perfaqesojne se do te mbrojne me vendosmeri marrëdhëniet ligjore te punes te cob sindikalisti.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCES
DREJTORIA E MENAXHIMIT TE PERGJITHSHEM

LËNDA: Sqarim për pikën 7 të Udhëzimit Nr. 29, datë 18.09.2006

DREJTUAR: Drejtorëve të Drejtorive Arsimore Rajonale
Drejtorëve të Zyrave Arsimore

Me porosi të Ministrat të Arsimit dhe Shkences, z. Genc Pollo, në pergjigje të shqetsimeve të disa DAR/ZA-ve lidhur me zbatimin e pikës 7 të Udhëzimit Nr. 29, datë 18.09.2006, të MASH-it "Për emerimet dhe levizjet e personelit mesimor dhe drejtues në arsimin parauniversitar", ju sqarojmë si më poshtë:

Pika 7 e Udhëzimit Nr. 29, datë 18.09.2006, duhet kuptuar dhe interpretuar në koherencë me aktet e tjera, si dhe me pikat paraprëse (3,4,6) të ketij Udhëzimi.

Lidhur me kriteret e punësimit të mesuesve, në pikën 4.4 të Kontrates Kolektive të datës 4 korrik 2006, të nënshkruar nga kryetari i SPASH-it, kryetari i FSASH-së dhe Ministri i Arsimit dhe Shkences, thuhet shprehimisht: "Për arsimin parashkollor dhe për ciklin e ulët të shkollës 9-vjeçare të paktën diplomën e shkollës së mesme pedagogjike, ose të një shkolle tjetër të profilizuar për mesuesi, siç janë shkolle e mesme e muzikës, artistike, të gjuhëve të huaja dhe fizikultures".

Në pikën 7 të Udhëzimit të MASH-it, posaçërisht për mesuesit dhe edukatorët e ko-

pshteve që kanë diplomë përkatese, por edhe për mesuesit dhe edukatorët e tjerë me arsim të mesëm pedagogjik, me emrim definitiv në arsimin parashkollor dhe CU të shkollave 9-vjeçare të qyteteve, qendër qarku dhe qendër rrethi, nuk është thënë që largimi i tyre të bëhet në mënyrë të menjëhershme, siç është interpretuar nga ndonjë DAR/ZA. Prandaj, në kuptimin e ketij Udhëzimi, mesuesit e CU dhe edukatorët me diplomë përkatese në qytetet qendër - qarku e rrethi nuk do të largohen nga detyra, ndërsa mesuesit e CU dhe edukatorët që rezultojnë me dëftesë pjekurie të shkollës pedagogjike, do të konsiderohen pa arsim përkatesë dhe, megjëse nuk plotesojnë kushtet për nivelin arsimor sipas ciklit, do të largohen në mënyrë graduale, duke mbajtur parasysh në çdo rast arditjet në punë, në mënyrë të arsimimit (ditën apo me korrespondencë), moshën e daljes në pension, kerkesat për punësim etj. Këta mesues mund të mbahen në punë si përjashtim dhe vetëm në mënyrë të përkohshme.

DREJTORI
LUAN KETA

Te njohim strukturen e pagave ne arsimin parauniversitar

Ne Kontraten Kolektive te Punes te dates 4 korrik 2006, nenshkruar midis FSASH e SPA-SH nga njera ane, dhe Ministrise se Arsimit e Shkences, nga ana tjetere, palet marrin persiper qe te konsultohen dhe te anri jne marreveshje per rritjen dhe pemi-resimin e struktures se pagave dhe te shperblimeve ne sistemin parauniversitar. Ne kete kuader dhe ne zbatim te programit qe ka

shpallur Qeveria per dyfishimin e pagave te mesuesve brenda mandatit 4 vjecar, u be ehte kete vit rritja e pagave ne arsim. Keshilli i Ministrave te Republikes se Shqiperise, me Vendimin nr. 440 date 13.07.2007, miratoi Strukturen e pagave per punonjesit mesimor parauniversitar per vitin 2007 e ne vijim. Ky vendim i shtrin efektet nga data 1 korrik 2007.

Ne baze te ketij Vendimi, paga bruto e mesuesve, qe nga arsimi parashkollor dhe deri ne shkollen e meare rritet, sipas prentimit te bere nga Qeveria, ne masen rreth 20 perqind.

Por, per shkak te aplikimit te takses se sheshte, paga neto e mesuesve, sipas vjetersise dhe kualifikimit rritet nga 11 deri ne 18 perqind. Pensa i perket pages neto me te favorizuar jane mesuesit e rinj.

Me qellim qe Seksionet Sindikale, Keshillat Sindikale ne Shkolla dhe cob sindikalist te kete mundesi te njihet realisht me kuadrin ligjor qe percakton pagat e tyre, po botojne te plote pasqyren mbi strukturen e Pagave per Punonjesit mesimor ne Sistemin Parauniversitar, miratuar me Vendimin nr. 440 date 13.07.2007 te Keshillit te Ministrave:

	EMERTIMI	PAGAMUJORE				Totali
		PAGAINDIVIDUALE			SHTESAEPROFESIONIT	
		Paga e Grupit (PG)	Shtesa per Vjetersi (SHV)	Shtesa per kualifikim (SHK)	Shtesa per pozicion (SHP)	
	1	2	3	4	5= (1+2+3+4)	
1	Drejtori Shkolles me eme. Pergjegjes Poligoni. Drejtori i Institutit te nxenesve qe nuk degjone dhe shikojne. Drejtor ne shkollat me problem te larta me ndore. Drejtor i Konvikteve	1	2% e PG	5% e PG 10% e PG 20% e PG	35.560	
2	Zv Drejtori i Shkolles me eme. Pergjegjes i bazes prdhuese. Zv Drejtori i Institutit te nxenesve qe nuk degjone dhe shikojne. Zv Drejtor ne shkollat me problem te larta me ndore.	1	2% e PG	5% e PG 10% e PG 20% e PG	28.500	
3	Drejtori i Shkolles 9-vjecare	1	2% e PG	5% e PG 10% e PG 20% e PG	27.950	
4	Drejtori i Shkolles fillore klase I-IV. Pergjegjes (Kryem esues i shkolles me klase kolektive. Zv. Drejtor i shkolles 9-vecare	1	2% e PG	5% e PG 10% e PG 20% e PG	25.800	
5	Drejtor i kopshtit me ushqim	1	2% e PG	5% e PG 10% e PG 20% e PG	24.200	
6	Drejtor i kopshtit pa ushqim	1	2% e PG	5% e PG 10% e PG 20% e PG	22.070	
7	M esues ne shkollat me eme. M esues ne institutin e nxenesve. qe nuk shikojne e nuk degjone. M esues ne shkollat me problem te larta me ndore.	1	2% e PG	5% e PG 10% e PG 20% e PG	25.750	
8	M esues ne shkollat 9-vjecare, klase I-IX. Edukator konvikti. Kujdestar konvikti	1	2% e PG	5% e PG 10% e PG 20% e PG	21.560	
9	Edukatore ne kopesht fem i jesh.	1	2% e PG	5% e PG 10% e PG 20% e PG	15.900	
10	M esues	2	2% e PG	5% e PG 10% e PG 20% e PG	17.600	
11	M esues	3	2% e PG	5% e PG 10% e PG 20% e PG	17.600	
12	Edukatore ne kopesht fem i jesh	3	2% e PG	5% e PG 10% e PG 20% e PG	15.750	
13	Edukatore ne kopesht fem i jesh	2	2% e PG	5% e PG 10% e PG 20% e PG	15.750	

Mbrojtja e anetareve lidhet me zhvillimet progresive ne arsim

Nga mbledhja e KD te FSASH

Mbledhja e Keshillit Drejtues te FSASH-it, e zhvilluar te prenten, date 7 shtator, me pjese-marrjen e anetareve te Keshillit, drejtues te seksioneve sindikale, pothuajse nga te gjitha mretet e vendit, diskutoi gjeresisht detyrat qe u dalin strukturave te kesaj Federate ne qender e ne rrethe, si edhe keshillave sindikale ne shkolla, ne kuadrin e fillimit te vitit te ri shkollor 2007-2008.

Situata e krijuar pas merrjes se dhunesme nga zyrtar e dy qendrave kryesore sindikale, KSSH e BESH, e cila ka prekur drejtperdrejt edhe FSASH, si edhe problemet e nprehta qe kane lindur ne lidhje me zbatimin e udhezimit te MASH per emerimet dhe levizjet e personelit arsimor, percaktuan tematikat kryesore te analizës ne kete mbledhje.

Ne fjalen hyrese qe mbajti Kryetari i Federates, Zoti Xhafer Dobrush, e quajti situaten aktuale shume te veshtire, pa nje zyre dhe pa kushtet me minimale per nje pune normale, si energji elektrike, pajisje dhe mjete pune etj, por, ne te njejten kohe, ai vuri ne dukje se jane te gjitha mundesite dhe po pundhet me te gjitha forcat qe ajo te kaproset me sukses, duke perdorur te gjitha menyrat, perfshire edhe kerkesat ndaj Qeverise dhe Ministrise se Arsimit per te permbushur detyrimet kushtetuese dhe kontraktuale qe ato kane per t'u krijuar sindikatave kushte pune dhe veprimtarie normale.

Ketij qellimi i shoben edhe takimi i dy kryetareve te sindikatave te arsimit ne Ministrin e Arsimit dhe Shkences, Zotin Genc Pollo, i zhvilluar nje dite para kesaj mbledhjeje, me te cilin u bisedua ne lidhje me kerkesat kryesore te dy sindikatave te arsimit ne kushtet e situates aktuale.

Pasi vuri ne dukje disa nga arrijtet e ketyre koheve te fundit, perfshire edhe tendencen per mritjen e vazhdueshme te pagave, Z.Xhafer

Dobrush i evidentoi problemet kryesore me te cilat po ballafaqohet aktualisht levizja sindikale ne sektorin e arsimit dhe disa nga drejtimet kryesore te punes se FSASH, ne kuadrin e fillimit te vitit te ri shkollor.

Zbatimimi rigoroz dhe menjanimi i qendrimeve ekstreme e ndonjehere te politizuara ne lidhje me Udhezimin e MASH, Nr. 29, date 18 gusht 2006 "Per emrimet dhe levizjet e personelit mesimor dhe drejtues ne arsimin parauniversitar", kaqon njehje te situates dhe reagim konkret. Rasti i Pogradecit dhe qendrimi i seksionit sindikal te ketij mreti, mbeshtetur nga Kryesia e FSASH-it, i cili coi ne nxjerrjen e nje Sgarimi te vecante te MASH, ne lidhje me zbatimin e ketij Udhezimi, tregon se ne i kemi te gjitha mundesite qe te mbrojme anetaret tane kunder cdo veprimi e qendrimi abuziv ndaj tyre.

Ky problem terhoqi vemendjen e mjaft prej anetareve te Keshillit, te cilet paraqiten raste konkrete, si ne Fier ku, sic theksoi Zv/Kryetari i ketij Seksioni, Lavdash Llanaj, jane larguar nga puna mbi 150 mesues, ne Shkoder, ku sic theksoi Kryetari i ketij seksioni, Isa Reka, mbi 55 etj. Edhe drejtues te tjere lokale qe diskutuan per kete ceshtje, si Hysen Gaci, Sarande, Shkëlqim Polloveshi, Kupove, Pertref Celaj, Vlore etj, kerkuan qe DAR dhe ZA te mbajne mire parasysh Sgarimin e leshuar nga MASH, duke theksuar se seksionet sindikale ne rrethe duhet te kenbergulin qe largimet nga puna te mesuesve te shpjegohen rast pas rasti, duke mbajtur parasysh arsimin perkates, por edhe eksperienca ne pune e tregues te tjere. Ata theksuan se nuk eshte e drejte qe te merret parasysh vetem fakti nese mesuesit qe kane nbaruar ne njejten shkolle pedagogjike, te diferencohen per t'u mbajtur ose jo ne pune, vetem nga fakti se kane Diplome apo Deftese Pjekurie, ku theksodet se ata kane nbaruar per mesuesi, pa analizuar faktoret e

tjere, sic jane vitet qe mesuesi ka punuar ne kete profesion, vleresimi i cilesise dhe rezultateve te punes se tij, etj.

Ne lidhje me masen e mritjes se pagave, ne kete mbledhje pati reagime te ndryshme, duke mbizoteluar opinionin se ne kete drejtim po behet nje propagande qe nuk ka shume baze reale. Nderkohe qe Qeveria flet per nje mritje prej 20-22 perqind, ne te vertete, per shkak te zbatimit te Takses se Sheshte, kjo mritje per pagen neto nuk shkon me shume se 11-12 perqind, me perjashtim te mesuesve qe sapo kane filluar punen ku ajo shkon deri 16-17 perqind. Disa prej drejtuesve sindikaliste shkuan edhe me tej, duke e konsideruar kete mritje edhe me te ulet, ose drejt zeros, por shkak se jane mritur shume amimet, pothuajse ne te gjitha produktet dhe sherbimet. Per kete ceshtje u la detyre qe keshillat sindikale te konsultohen me anetaret dhe mesuesit ne teresi per te arritur ne nje konkluzion te pergjithshem dhe per te mbajtur nje qendrim te bazuar e objektiv ne te ardhmen.

Nje tjetër problem i ngritur me shqetesim ne kete mbledhje, si ne Fjalen Hyrese, ashtu edhe ne diskutime, ishte ai i qendrimeve te padrejta te disa qendrave ekonomike te bashkive e komunave, ne lidhje me dhenien e sferblimit deri ne dy paga per mesuesit qe dalin ne pension, sipas Kontrates Kolektive te punes ne fuqi. Shkak per kete eshte interpretimi i gabuar i Vendimit te Qeverise per Fondin e Vecante, ku percaktodet se punonjesve nuk mund t'u jepet me shume se nje page mujore sferblimit ne vit.


Zoti Xhafer Dobrush i sqaroi se kjo ceshtje ishte objekt diskutimi edhe ne takimin me Ministrin, ku u pranua arsyetimi se nuk ka asnje lidhje midis ketij Vendimi te Qeverise dhe Nenit 8/13 te Kontrates Kolektive te Punes, mbasi Vendimi ben fjale per punonjesit qe jane dhe vazhdojne te jene ne

mardhenie pune, ndersa Kontrata Kolektive ka te beje me ndeprerjen e mardhenieve te punes. Ne mbledhje u kerkua qe seksionet sindikale te ndjekin me pergjegjesi zbatimin e kesaj te drejte te siguruar me Kontraten Kolektive dhe te reagojne per cdo problem qe mund te krijojhet, por ndersa, u kerkua qe kjo e drejte te mos shperdorohet, t'u jepet vetem atyre qe e meritojne sipas kriterave te percaktuara, gje qe duhet te zotchet nga te dyja sindikatat, sepse ka patur raste qe mesuesve te vecante u jane leshuar vertetimet nga sindikata tjetere, kur nuk kane mundur t'i marrin nga njera prej tyre.

Zbatimimi i Kontrates Kolektive te Punes ne teresine e saj e sidomos te disa neneve te reresishme, terhoqi vemendjen te vecante ne kete mbledhje. Mjafte diskutante theksuan se drejtuesit dhe punonjesit e DAR e ZA-ve nuk e njohin Kontraten Kolektive, per rrjedhoje, edhe nuk e zotojne ate, duke kerkuar nga Kryesia e Federates qe te shche mundesine e organizimit te ndonje seminarit a takimi me ta, per te bere spjegime dhe per te kerkuar njohjen dhe zbatimin e saj, ndersa qe MASH-it duhet t'i kerkodet me insistim qe te zotoje pikat "a" dhe "b" te nenit 8/7, ne lidhje me hartimin e kuadrit nenligjor, pa hartimi i projekt VKM-ve, me qellim qe te gjitha mesuesit te perfitojne vjetersine ne pune ne masen 2 perqind, edhe ne ato raste kur vitet e punes nuk i kane ne arsim, si dhe mritjes nga 20 ne 25 perqind te shites per kualifikimet per ata mesues qe kane nje vjetersi pune mbi 25 vjete.

Objekt i vecante diskutimi ne kete mbledhje ishin ceshtjet qe kane te bejne me forcimin e gjithanshem te strukturave drejtuese te Federates ne te gjitha nivelet.

Ne fjalen e vete Zoti Xhafer Dobrush, terhoqi vemendjen per nje pune me te organizuar e me



SINDIKATA E PAVARUR
E ARSIMIT TË SHQIPËRISË



FEDERATA E SINDIKATAVE
TË ARSIMIT TË SHQIPËRISË



MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SHKENCËS

KONTRATE KOLEKTIVE

Sot, më datën 4 korrik 2006, në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, në prani të palëve, nënshkruhet kjo Kontratë Kolektive Pune midis:

Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, përfaqësuar nga Ministri z. Genc Pollo, nga njëra anë dhe:

- Federatës së Sindikatave të Arsimit dhe Shkencës të Shqipërisë (FSASH), përfaqësuar nga Kryetari, z. Xhafer Dobrushhi

- Sindikatës së Pavarur të Arsimit të Shqipërisë (SPASH), përfaqësuar nga Kryetari z. Bajram Kruja, nga ana tjetër.

Të dy palët, mbas negociemeve të

Neni 1
Baza ligjore

Kjo Kontratë Kolektive nështetet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në nenet 50 dhe 51, në Konventat Ndërkombëtare të Punës, veçanërisht në Konventat nr. 87 dhe 98, në Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë, në nenet 159-188 dhe në akte të tjera ligjore e nënligjore që kanë të bëjnë me marrëdhëniet e punës në tërësi dhe ato në fushën e arsimit në veçanti.

Kjo Kontratë Kolektive Pune, nështetet gjithashtu në dispozitat e Kontratës së mëparshme Kolektive të nënshkruar me 15 Maj 2002 dhe në bazë të nenit 114 të Kodit të Punës, ruan e miron arditjet e saj të deritanishme në favor të punëmarësve, veçanërisht në fushën e shpërblyemeve, të kushteve të prës, lirive sindikale etj.

Neni 2

Fusha e zbatimit të Kontratës

2.1. Kjo kontratë i shtrin efektet e saj mbi të gjithë personelin mësimor të sistemit parauniversitar, përfshin edukatorët e kushteve, nësuesit e ciklit

zhvilluara, arritën në përfundimin që të përsëritin Kontratën e deritanishme Kolektive të Punës, duke i bërë asaj plotësimet dhe përmirësimet e nevojshme dhe duke e shtrirë periudhën e Kontratës së re nga data e nënshkrimit të saj deri në 31 Dhjetor 2009.

Në procesin e negociimit me punëdhënësin, të dy sindikatat nënshkruese provuan edhe një here identitetin e tyre, përfshirë depozitimin e vendimeve në Gjykatën e Tiranës, që i njih ato si persona juridike, statutet përkatëse, numrin e anëtarësisë me lista dhe me kuotizacion, si dhe Marrëveshjen

të ulët dhe të lartë të shkollës 9-vjeçare, nësuesit e shkollave të mesme të përgjithshme, profesionale e speciale.

2.2. Për arsimin parashkollor dhe parauniversitar, për punonjësit ndihmës që janë në vartësi të Drejtorive Arsimore Rajonale, kontratat kolektive të nivelit të dytë lidhen midis DPA dhe Seksioneve Sindikale të dy sindikatave nënshkruese të Kontratës Kolektive të nivelit të parë.

2.3. Dispozitat e Kontratës Kolektive të nivelit të parë janë të detyrueshme për zbatim nga të gjitha nivelet e tjera që legjitimohen për nënshkrimin e Kontratave Kolektive të nivelit të dytë, në kuptimin që këto subjekte nuk mund të përfshijnë në kontratë më pak të drejta për punëmarësit se sa Kontrata Kolektive e nivelit të parë.

2.4. Palët nënshkruese në kontratat kolektive të nivelit të dytë, nështetur në natyrën e kërkesave në nivel lokal, në veçoritë e kushteve të punës, mund të përfshijnë në kontratën kolektive të nivelit të dytë të drejta dhe përfitime në favor të punëmarësve në një vëllim në të madh se ato të nivelit të parë, me kusht që këto të drejta dhe përfitime të mos bien në kundërshtim me dispozitat

që kanë të dy sindikatat për t'u paraqitur si palë e vetme përpara punëdhënësit për negociimin dhe nënshkrimin e Kontratës Kolektive të Punës. Në bazë të këtyre dokumenteve, SPASH dhe FSASH rikonfirmohen nga punëdhënësi, si partnerët e vetëm në rolin e punëmarësit për gjithë sistemin e të punësuarve në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

Te dy palët konfirmojnë se në përfundim të bisedimeve arritën të formulojnë dhe nënshkruajnë tekstin përfundimtar të Kontratës së re Kolektive të Punës, me përmbajtjen që vijon:

e shprehura në mënyrë ndaluese në legjislacionin e marrëdhënieve të punës ose dispozitat e Kontratës Kolektive të nivelit të parë.

25. Pala e sindikatës në momentin e lidhjes së kontratave të nivelit të dytë, duhet të paraqesë listën zyrtare të anëtarëve të sindikatës së saj.

Neni 3

Kohëzgjatja e Kontratës

Kjo Kontratë Kolektive do të zbatohet nga data e nënshkrimit të saj dhe deri në 31 Dhjetor 2009. Mbas këtij afati, nështetur në nenin 173 pika 3 të Kodit të Punës, Kontrata Kolektive mund të zgjidhet me kërkesën e secilës palë, por me kusht që pala e interesuar të njoftojë tërheqjen 6 muaj më parë.

Neni 4

Punësimi

4.1. Të dy palët bien dakord që kur ndodhin mosmarrëveshje ose konflikte që kanë të bëjnë me marrëdhëniet e punës, përfshirë masat disiplinore, transferimet, largimet nga puna, shpërblyemet, pagat, lejet e zakonsme

dhe të jashtëzakonshme etj, SPASH dhe FSASH marrin në mbrojtje, duke u ballafaquar vetë si institucione me punëdhënësin e çdo niveli, vetëm ata mësues apo punonjës që janë anëtarë të tyre.

4.2. Anëtarë të sindikatës konsiderohen vetëm ata mësues apo punonjës, që janë deklaruar me shkrim për anëtarësimin në njerën nga sindikatat nënshkruese të kësaj kontrate dhe që paguajnë rregullisht kutizacionin sindikal, sipas mënyrës dhe masës që përcaktohen në Statutet e secilës sindikate.

4.3. Kriteret për punësim që prandhen nga të dy palët nënshkruese me këtë Kontratë Kolektive, të cilat janë të nënshtrtura në dispozitat përkatëse të Kodit të Punës dhe në Konventat Ndërkombëtare të Punës, duhet të jenë të harmonizuara me Aktet Normative që miratohen dhe nxjerr Ministri i Arsimit dhe Shkencës dhe nuk duhet të ketë mospajtim midis tyre.

4.4. Më kryesoret nga këto kritere janë:

a. Punonjësit që do të punësohen në sistemin arsimor parauniversitar duhet të kenë mbushur moshën 18 vjeç.

b. T'i përgjigjen nivelit arsimor për të gjitha ciklet, sipas kritereve që ka miratuar Ministri i Arsimit dhe Shkencës në Aktet Normative dhe konkretisht:

- Për arsimin parashkollor dhe për ciklin e ulët të shkollës 9-vjeçare, të paktën diplomën e shkollës së mesme pedagogjike, ose të një skolle tjetër të profilizuar për mësuesit, siç janë shkollat e mesme të muzikës, artistike, të gjuhëve të huaja dhe fizikulturës.

- Për ciklin e lartë të arsimit bazë, diplomë të shkollave të larta të mësuesisë 4 ose 3 vjeçare, si edhe diplomë të ish-Institutive Pedagogjike dy vjeçare.

- Për t'u punësuar si mësues i përhershëm në shkollën e mesme, i punësuar duhet të disponojë diplomën universitare të shkollës së lartë.

- Personi që merret në punë për herë të parë pajiset nga punëdhënësi me Librezë Pune, e cila është unike për të gjithë të punësuarit, sipas modelit të përcaktuar nga organi kompetent.

4.5. Në vitin e parë të punësimit, që vjen menjëherë pas nbarimit të shkollës, i

punësuarit në arsim në të gjitha nivelet, që nga kopshtet deri në shkollën e lartë punësohet me kontratë individuale me afat të caktuar, (neni 149 i Kodit të Punës). Ky afat në të gjitha rastet është njëvjeçar.

Nëse me nbarimin e këtij afati nuk do të ekzistojnë kushte ligjore ose të parashikuara në këtë Kontratë Kolektive, që e bëjnë të pamundur vazhdimin e marrëdhënieve të punës dhe kur punëdhënësi u është përgjigjur me korrektesë detyrimeve që përmban për të kontrata individuale, atëherë i punësuarit fiton të drejtën e punësimit me kontratë pune pa afat të caktuar.

4.6. Gjatë periudhës njëvjeçare të punës, mësuesit, edukatorët ose mësimepunëdhënësit e tjerë gëzojnë po ato të drejta që gëzojnë edhe kolegët e tyre të punësuar në mënyrë definitive.

4.7. Punëdhënësi nuk mund të zgjidhë kontratën e punës pa shkaqe të arsyeshme. Shkaqe të paarsyeshme konsiderohen ato që përmban neni 146, pika 1, shkronjat a, b, c, d, dhe e, i Kodit të Punës.

4.8. Zgjidhja e marrëdhënieve të punës nga punëdhënësi pa shkaqe të arsyeshme është e pavlefshme. Në këtë rast punëdhënësi detyrohet t'i paguajë dëmshpërblim punëdhënësit deri në një vit pagë dhe, me kërkesën e Sindikatave Qendrore nënshkruese të kësaj Kontrate ose me vendim gjykate të formës së prerë, ta rikthejë punëdhënësin në punën e mëparshme. (Neni 146, pika 3 e KP).

4.9. Kur ekzistojnë shkaqe të arsyeshme, për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës, siç është reforma në arsim, pakësimi i numrit të nxënësve, etj., punëdhënësi është i detyruar të zbatojë ndaj punëdhënësit këto afate njoftimi:

- Një muaj për të punësuarit që kanë një vit pune.

- Dy muaj për të punësuarit që kanë dy deri në pesë vjet pune

- Tre muaj, për të punësuarit që kanë më shumë se 5 vjet pune.

4.11. Zgjidhja e menjëhershme e marrëdhënieve të punës nga punëdhënësi ose punëdhënësi bëhet duke respektuar dispozitat e neneve 153 deri 156 të KP.

Punonjësit jo mësuesorë, përfshirë të punësuarit në administrate, në konvikte, pastueset, rojet etj., kur merren në punë për herë të parë i nënshtrohen periudhës 3 mujore të provës, sipas nenit 142 të Kodit të Punës.

Kushtet dhe kërkesat që duhet të plotësojnë punonjësit jo mësuesorë në arsimin parauniversitar në periudhën e provës, miratohen nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës, në konsultim me sindikatat nënshkruese të Kontratës Kolektive të Punës.

4.12. Punonjësit që nuk plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 4.4, 4.5 dhe 4.7 të kësaj Kontrate Kolektive, mund të punësohen në arsim si përjashtim dhe vetëm në mënyrë të përkohshme.

4.13. Kur për një vend pune konkurrojnë dy ose më shumë kandidatura, punëdhënësi, drejtori i DAR ose drejtori i ZA, krijon një komision të posaçëm me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të sindikatave, i cili bën përzgjedhjen mbi bazën e këtyre kritereve:

- Nivelin arsimor, notën mesatare, vjetërsinë në punë në arsim, duke preferuar ata mësues që kanë punuar për një periudhë në të gjatë se 3 vjet larg vendbanimit ose në zra të vështira.

- Kurset e kualifikimit dhe specializimit e njdhura nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, përfshirë titujt shkencorë ose pedagogjikë që ka mbrojtur dhe fituar kandidati që konkurron.

4.14. Kushtet e punësimit të personelit në institucionet e arsimit special dhe të institucioneve të tjera botuese ose të shërbimit do të trajtohen me kontrata të nivelit të dytë.

4.15. Në vendet që krijohen të lira për punësim, përveç kritereve të përcaktuara në nenin 4.13, kanë përparësi edhe mësuesit e cilësuar "invalidë pune" me vendim të komisionit përkatës.

Neni 5

Ndërshimi i vendit të PUNËS

5.1. Sindikatat nënshtrëtin kërkesat e anëtarëve të tyre të punësuar në arsim

Vijn nga faqja 9

për ndryshimin e vendit të punës. Sindikatat, së bashku me kërkesën e të punësuarit, i paraqitin punëdhënësit përkatës edhe mendimin e tyre me shkrim dhe të argumentuar, jo më vonë se data 15 maj të çdo viti.

5.2. Miratimin ose mosmiratimin e kërkesës së punëmarrësit për ndryshimin e vendit të punës, punëdhënësi është i detyruar t'ia njoftojë me shkrim punëmarrësit 30 ditë para fillimit të vitit të ri shkollor, duke parashtruar edhe argumentet përkatëse.

5.3. Ndryshimet e vendit të punës të bëra për shkakë dojqitive me iniciativën e punëdhënësit, bëhen vetëm për raste të veçanta dhe për nevoja mëdhorë në arsim. Si rregull, punëmarrësit i ndryshohet vendi i punës vetëm para fillimit të vitit mësimor dhe duhet t'u pëmbahet këtyre kriterëve:

- Kualifikimit,
- Vjetërsisë në punë,
- Rezultateve në punë,
- Nivelit arsimor,
- Gjendjes shëndetësore, në kuptimin që lëvizja në punë nuk duhet të ndikojë në keqësimin e shëndetit të punëmarrësit.
- Kushteve ekonomike dhe të jetesës, në kuptimin që lëvizja në punë nuk duhet të sjellë për punëmarrësin uljen ose përkeqësimin e këtyre kushteve.
- Disiplinës në punë dhe zotimit të ligjt.

- Për gratë me fëmijë nën moshën tre vjeç, lëvizja në punë nuk bëhet kur rruja vajtje-ardhje zgjat në shumë se 30 minuta në këmbë, me përjashtim të rasteve kur transferimi bëhet me kërkesën e punëmarrësit ose është në favor të tij.

5.4. Në çdo rast ndryshimi i vendit të punës bëhet vetëm brenda njësisë administrative në juridiksion të Zyrës Arsimore dhe Drejtorisë Arsimore Rajonale.

5.5. Urdhri për ndryshimin e vendit të punës duhet t'i jepet punëmarrësit me shkrim dhe i motivuar, 30 ditë para ekzekutimit të parashkuar.

5.6. Punëdhënësi është i detyruar të

ruajë vendin e punës:

- për gratë shtatzana ose me leje për mirënjohjen e fëmijëve,
- për punonjësit që nuk gëzojnë shëndet të plotë dhe që këtë e provojnë me raport mjekësor, për aqkthë sa zgjat pëaftësia e përkohshme. Këtë të drejtë e përfitojnë edhe punëmarrësit që marrin leje për kujdes familjar, me ose pa të drejtë rroge sipas akteve ligjore dhe rënligjore në fuqi.

5.7. Me kërkesën e sindikatave nënshkruese, punëdhënësi është i detyruar t'i verë në dijeni atpër motivet e transferimit, për pasojat juridike, ekonomike dhe sociale që vijnë në këtë rast.

Kur ka kundërshtime nga sindikata ose i interesuari, brenda 30 ditëve nga marrja e këtij njoftimi, palët duhet të bëjnë konsultime dhe të gjejnë zgjidhjet ligjore, në të kundërt secila palë rezonon të drejtën t'i drejtohet Zyrës së Pajtimit, në rast të kundërt i drejtohen Gjykatës, vendimet e të cilës janë të detyrueshme për palët.

5.8. Punëdhënësi mund t'i ndryshojë vendin e punës punëmarrësit gjatë procesit mësimor vetëm në raste përjashtimore:

- Kur kemi të bëjmë me thyerje të rënda të disiplinës në punë, me shkelje të ligjit ose të kontratës kolektive.
- Për nevoja mëdhorë në arsim. Në këto raste duhet të merret meberos pëlqimi i FSASH ose SPASH, kur dojqet i lëvizjes në punë janë anëtarët e tyre dhe lëvizja nuk mund të zgjatë më shumë se 1 vit.
- Kur nuk plotësohet norma e ngarkesës mësimore për punëmarrësin.

Neni 6 Koha e PUNËS

6.1. Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në bashkëpunim me sindikatat nënshkruese të kësaj Kontrate, brenda vitit 2007 të studiojë ngarkesën mësimore të mësuesve të arsimit parauniversitar, duke përfshirë në elementin "ngarkesë" edhe komponentë të tjerë, të cilët mësuesi i përballon aktualisht, por që nuk i njihen në ngarkesë.

6.2. Kohëzgjatja e punës javore është 5 ditë në javë, nga e hëna deri të pranten.

6.3. Ngarkesa aktuale mësimore javore për punonjësit mësimorë (edukato-rët) në arsimin parashkollor është 30-36 orë në javë.

6.4. Ngarkesa mësimore javore për punonjësit në arsimin 9-vjeçar dhe të mesëm të jetë konform Udhëzimeve të Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës. Mësuesit të ciklit të ulët dhe mësuesit që ka klasë në kujdestari, i karasvlerësohet kjo punë me një orë suplementare.

6.5. Ngarkesa mësimore e punonjësave mësimorë në arsimin parauniversitar do të jetë në përputhje me udhëzimin përkatës të Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës.

6.6. Ngarkesa aktuale mësimore e mësuesve të cilësuar "invalidë pune" do të jetë në përputhje me Vendimin e KMCAP.

6.7. Mësimdhënësit gëzojnë të drejtën për punë suplementare të pagueshme deri në 30% të ngarkesës mësimore.

6.8. Mësuesit e cilësuar "invalidë pune" nuk mund të ngarkohen mbi normë.

6.9. Në rastet kur nuk plotësohet norma mësimore pagesa të bëhet konform udhëzimeve për ngarkesën mësimore.

6.10. Orët shtesë mbi normë për veprimtaritë mësimore-edukative në ditët e pushimit javor për realizimin e programit ose të aktiviteteve zyrtare që bëjnë DAR dhe ZA, do të pagohen sipas neneve 91, pika 3 e KP.

6.11. Mësuesi është i detyruar të paraqitet në shkollë 20 minuta para fillimit të mësimit të tij. Mas kryerjes së orëve ditore të mësimit, nëse nuk ka angazhime të tjera që lidhen me detyrën e tij si mësues dhe detyrat që i ngarkohen nga drejtoria e shkollës, ai mund të largohet nga shkolla.

6.12. Në raste të veçanta, me miratimin e Drejtorisë Arsimore, mund të angazhohen edhe mësues që janë në pritmëri për t'u emëruar ose mësues pensionistë, deri në 10 orë mësimi në javë, plus orët e provimeve sipas akteve rënligjore.

6.13. Koha e punës për të punësuarit e tjerë të përcaktuar në Nenin 2 të kësaj

Kontrate rregullohet me VKM.

6.14. Ministria e Arsimit dhe Shkencës angazhohet të marrë masat e nevojshme për normalizimin e numrit të nxënësve në klasë, në ato zona ku ky fenomen është problem.

6.15. Ministria e Arsimit dhe Shkencës të marrë masat e nevojshme për studimin e numrit të nxënësve për klasë, në sistemin arsimor parauniversitar, me synimin që të arrijë gradualisht në 32 nxënës për klasë.

Neni 7

Koha e pushimit

7.1. Edukatorët e arsimit parashkollor gëzojnë të drejtën e lejes vjetore të pagueshme prej 32 ditë pune në vit pa ndërprerje.

7.2. Mësuesit e shkollave 9-vjeçare dhe të mesme të gjitha kategorive si dhe pedagogët e shkollave të larta gëzojnë të drejtën e një lejeje vjetore të pagueshme prej 56 ditë pune, e cila përfshin, përveç pushimeve verore, edhe ditët e pushimit kur mësimi ndërpritet sipas programit mësimor vjetor. Për periudhën e verës koha e pushimit nuk mund të ndërpritet më shumë se një herë dhe kjo vetëm për punë arsimore dhe edukative.

7.3. Të punësuarit në institucionet që varen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, administrata e sistemit arsimor, si edhe punonjësit e shërbimeve gëzojnë të drejtën e pushimeve vjetore sipas kriterëve të caktuara me VKM, por jo më pak se 4 javë kalendarike.

7.4. Për efekt të lejes vjetore, në kohën e punës llogaritet edhe koha e paftësisë së përkohshme në punë.

7.5. Punëtarësit anëtarë të sindikatave nënshkuese të kësaj Kontrate, në rast martesë ose vdekjeje të bashkëshortit, të paraardhësve ose pasardhësve të tyre të drejtpërdrejtë, të motrave dhe vëllezërve, përfitojnë një pushim të paguar prej 5 ditësh.

7.6. Në rast sëmundjeje të rëndë të paraardhësve ose pasardhësve të drejtpërdrejtë, të vërtetuar me raport mjekësor, punonjësit e arsimit, anëtarë të sindikatave nënshkuese të kësaj Kontrate, përfitojnë deri në 10 ditë leje të papagueshme në muaj, por jo më

shumë se 6 muaj rresht.

7.7. Me kërkesën e SPASH dhe FSASH, të zgjedhurve në kryesitë e sindikatave në shkallë rrethi dhe këshilli sindikal, u sigurohet leje e pagueshme për të marrë pjesë në veprimtaritë sindikale lokale, kombëtare e ndërkombëtare. Kërkesa i paraqitet DAR ose ZA nga kryesitë e seksioneve sindikale vendore, të paktën 5 ditë para aktivitetit.

Neni 8

Sistemi i pagave dhe SHPËRBLIMEVE

8.1. Mëshetur në Strategjinë e Arsimit parauniversitar dhe në Programin e Qeverisë, që e konsideron arsimin si sektor parësor, të dy palët bien dakord që të ndërtojnë e zbatojnë një sistem pagash dhe shpërblimesh që mundëson një vlerësim në të mirë të figurës dhe punës së mësuesit e pedagogut dhe një motivim në të madh të tij, në bazë të angazhimit në procesin e reformimit e modernizimit të arsimit dhe të cilësisë së punës që kryen.

8.2. Punëdhënësi dhe punëtarësi bien dakord që, në bazë të dispozitave të Kodit të Punës, të Kartës së Lirive dhe të Drejtave të Njeriut dhe të Kartës Sociale Evropiane, të garantojnë për të punësuarit pagë të barabartë për punë të barabartë dhe profesion të njejtë, pa asnjë dallim.

8.3. Pagat e punonjësve mësimorë dhe ndihmës në sistemin e arsimit parauniversitar janë sipas strukturës së pagave të miratuara me VKM nr. 194 datë 22.04.1999 dhe të plotësimeve, shtesave e ndryshimeve të bëra në këtë vendim, ose me vendime të veçanta të Këshillit të Ministrave, që lidhen me rritjet dhe pëmirësimet e herëpashershme të pagave të punonjësve të arsimit.

8.4. Në bazë të nenit 1 të Ligjit nr. 8487 datë 13.05.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", për ndryshimet, shtesat, plotësimet, pëmirësimet dhe rritjet e mëtejshme të pagave të punonjësve të sistemit të arsimit parauniversitar, që mirrohen me këtë Kontratë Kolektive, punëdhënësi

është i detyruar që në procesin e hartimit të buxhetit të çdo viti të konsultohet dhe të marrë mendimin e sindikatave nënshkuese të kësaj Kontrate Kolektive, përpara se propozimet përkatëse të dërgohen në Qeveri.

8.5. Në bazë të nenit 21 të Kartës Sociale Evropiane për të drejtën e partnerëve socialë për informim dhe me qëllim që të luftohen me efikasitet shpërdorimet dhe korrupsioni në menaxhimin e buxhetit të arsimit, sidomos për pagat, shpërblimet, shpenzimet operative dhe investimet, punëdhënësi është i detyruar që të njohë përfaqësuesit kryesorë të Sindikatave Qendrore me të gjitha të dhënat përkatëse financiare, të burimeve njerëzore, etj.

8.6. Paga e përcaktuar në pikën 3 të këtij neni të kësaj Kontrate Kolektive është e garantuar për të gjithë të punësuarit në arsim në mënyrë definitive.

8.7. Me kërkesën e sindikatave nënshkuese të Kontratës Kolektive, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, bie dakord t'i propozojë Qeverisë, që në Vendimin e KM nr. 194 datë 22.04.1999, të bëhen këto shtesa:

a. Në lidhjen nr. 1 "Struktura e pagës për vjetërsi mësimore", që i bashkëngjitet këtij vendimi, në kolonën "shtesa për vjetërsi në punë", shtesa prej 2% në vit të jetë për vjetërsi në punë dhe jo vjetërsi në profesion, duke shfuqizuar pikën (2) II, të vendimit nr. 194.

b. Në kolonën "shtesa për kualifikim" të po kësaj Lidhjeje të shtohet një element i katërt për ata mësues që kanë rriti 25 vjet pune, të cilët shtesën për kualifikim duhet ta përfitojnë jo 20% siç është sot, por 25%.

8.8. Shpërblimet dhe përfitimet që lidhen me pikën 8 të këtij neni janë:

a. Kur jemi përpara kërkesave që lidhen me nevoja madhore në arsim, siç është rasti kur në zona të thella apo të largëta rurale, ose si përjashtim edhe në zona urbane, ka mungesa mësuesish me arsim përkatës, drejtorët e DAR ose ZA, mbasi marrin mendimin me shkrim

Vijon nga faqja 11

të partnerëve sindikalë vendorë, mund të emërojnë dhe dërgojnë në këto vende pune mësues me kualifikimin përkatës, vetëm me kontratë njëvjeçare, e cila mund të përsëritet, duke i paguar sipas vendimeve në fuqi.

b. Në fund të çdo viti mësimor, DAR dhe ZA, në bashkëpunim me seksionet sindikale përkatëse, duke u mbështetur në auditimet e kryera dhe në vlerësimet që bëjnë drejtorët e shkollave dhe këshillat sindikale përkatëse, shpallin për çdo shkollë e mreth mësuesit në të mirë të vitit.

8.9. Kur mësuesit kryejnë ore mësimi mbi ngarkesën mësimore vjetore të parashikuar në këtë kontratë, orët suplementare u paguhen sipas dispozitave ligjore e nënligjore në fuqi.

8.10. Mësimdhënësit që punojnë larg vendbanimit të tyre marrin një shtesë në pagë sipas kriterëve që pëmban V.K.M nr. 230, datë 19.04.2006. Masa e shpërblyimit për mësuesit që punojnë brenda njësisë administrative të DA të tyre dhe që kthehen brenda ditës në shtëpi bëhet sipas vendimeve përkatëse për pagesa.

8.11. Mbështetur në nenin 117 të Kodit të Punës, nga paga mujore e mësuesit bëhen vetëm këto zbritje:

- a- Tatimi mbi të ardhurat e punonjësit.
- b- Kontributet e sigurimeve shoqërore të caktuara me VKM.
- c- Kutizacioni i anëtarësisë në sindikatë mbi bazë vullnetare.

8.12. Sindikatat, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, marrin përsipër të negociojnë me Këshillin e Ministrave, për masën e shpërblyimit, nga fondi i veçantë, të punonjësve mësimorë të sistemit të arsimit parauniversitar, në raste evenimentesh, fatkeqësish, martesë, vdekje në familje etj.

8.13. Me autorizim me shkrim nga sindikatat nënshkruese të kësaj kontrate kolektive, mësuesit që dalin në pension përfitojnë deri në dy paga mujore shpërblyim, brenda buxhetit vjetor të planifikuar për çdo njësi administrati-ve, si dhe në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Neni 9

MBËSHTETJA E

STRATEGJISË, REFORMIMIT DHE MODERNIZIMIT TË ARSIMIT

9.1. Sindikatat nënshkruese të kësaj kontrate kolektive, konfirmojnë se arsimit cilësor publik dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës do të jenë prioritet i punës së tyre, se mbështesin dhe përfshihen aktivisht në procesin e zbatimit të Strategjisë së Arsimit, për reformimin dhe modernizimin e këtij sektori dhe se vlerësojnë programin e Qeverisë që e ka shpallur arsimin sektor prioritar.

9.2. Njëpërmjet seminareve, tryezave, diskutimeve në këshillat sindikale e forumet sindikale, sindikatat do të zërthejnë aspekte të veçanta të Strategjisë së Arsimit, përfshirë kurrikulat, procesin e vlerësimit, të motivimit, tekstet etj, duke e vënë theksin në njohjen dhe zbatimin e këtyre kërkesave nga mësuesit dhe antarët sindikal.

9.3. Të dy sindikatat bien dakord që të bashkërendojnë punët për arritjen e këtyre qëllimeve.

Neni 10

ANGAZHIM PËR ULJEN E NUMRIT TË FËMIJËVE QË BRAKTISIN SHKOLLËN DHE ELEMENIMIN E PUNËS SË FËMIJËVE.

10.1. Të dy sindikatat e arsimit, FSASH E SPASH, angazhohen që me mundësitë e tyre dhe me mbështetje të tjera, sidomos nga Federata Ndërkombëtare e Arsimit, EI, nga sindikatat homologe, etj, të bëjnë një punë të veçantë për uljen e numrit të fëmijëve që braktisin shkollën dhe eliminimin e punës së fëmijëve.

10.2. Njëpërmjet trajnimeve të drejtuesve sindikal dhe të anëtarëve të sindikatave si dhe njëpërmjet formave të tjera të punës konkrete në shkollë e në komunitet, ato do të synojnë për mitjen e mësuesve të angazhuar në një punë të veçantë me nxënësit që braktisin shkollën ose që janë në rrezik për ta braktisur atë, duke krijuar për ta një mjedis në tërëqësi dhe në prindëror dhe

duke pasur si dobjektiv eliminimin e punës së fëmijëve.

10.3. Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, duke e patur si një mër prioritetet e strategjisë së saj, mbështet këtë angazhim dhe siguron gadishmërinë e administratave të shkollave për veprime të përbashkëta, duke nxitur edhe përfshirjen e organeve të nxënësve dhe prindërve që veprojnë në shkollë.

Neni 11

Kushtet e punës

11.1. Shteti subvencionon shpenzimet për transportin e mësuesve dhe nxënësve të arsimit të detyruar që punojnë e mësojnë larg vendbanimit të tyre dhe që kthehen brenda ditës në vendbanim sipas vendimeve përkatëse.

11.2. Në kuadrin e marrëveshjeve midis dy palëve, të përcaktuara nga Ministria e Arsimit dhe shkencës, në konsultim me sindikatat, kriteret për kualifikimin e mësuesve.

11.3. Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në konsultim me sindikatat, të përcaktojnë kriteret për përzgjedhjen, emërimin dhe kualifikimin e drejtuesve të shkollave.

11.4. Bazuar në Udhëzimin nr. 2 datë 25.06.2004 të Ministrisë së Punës, Qështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Ministrisë së Shëndetësisë, të punësuarit në arsim si edukatore kopshti ose mësues në sistemin parauniversitar përfitojnë një herë në vit një ekzaminim mjekësor falas.

Neni 12

Marrëdhëniet me pushtetin vendor, komunat, bashkitë, qarqet dhe prefekturat

12.1. Ministria e Arsimit dhe Shkencës merr përsipër që DAR dhe ZA të paraqiten si palë e përbashkët me Seksionet Sindikale në mrethe përpara komunave, bashkive, këshillave të qarqeve dhe prefektëve, për :

- a -sigurimin e kushteve normale të punës në shkollë, ruajtjen dhe mirëmbajtjen e mjediseve të saj;
- b - sigurimin e transparencës për mjetet financiare që caktojnë Këshillat e

Qarqeve, të Komunave dhe Bashkive për arsimin dhe mirëmbajtjen e tyre; c - zbutjen dhe eliminimin e fenomenit të punës së fëmijëve;

d- të ndihmuar seksionet sindikale për vjeljen e kuotizacioneve të anëtarëve-sisë, duke i zbritur ata nga paga në listë pagesa, mbështetur në nenin 117/2 dhe 181 pika 7, shkronja "c" e Kodit të Punës.

Këto veprime, sektorët ekonomike të komunave dhe bashkive i kryejnë një herë në 6 muaj, ose kur është e mundur me shpesh dhe vetëm mbasi sindikatat paraqesin pranë qendrave ekonomike ose zyra të llogarisë së tyre, listat e anëtarëve, në të cilat mësuesi ose punonjësi i anëtarësuar deklaron se është anëtar i sindikatës pëkatëse për një periudhë prej jo më pak se një vit dhe se autorizon pagesën e kuotizacionit nëpërmjet listë-pagesave.

12.2. Masa e kuotizacionit për çdo anëtar përcaktohet në statutet, që secila sindikatë ka depozituar pranë punëdhënësit, ose në vendime të posaçme të këshillave të tyre drejtuese, duke respektuar marrëveshjet që sindikatat kanë ndërmjet tyre.

Neni 13 Liritë sindikale

13.1. Ministria e Arsimit dhe Shkencës tërheq vazhdimisht mendimin e sindikatave nënshkruese të kësaj Kontrate Kolektive në procesin e hartimit të Akteve ligjore e nënligjore që lidhen me reformën në arsim, me marrëdhëniet e punës, pagat, shpërblyerjet, kushtet e punës, etj.

13.2. Sindikatat nënshkruese të kësaj Kontrate të pajisen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës me aktet e nxjerra prej saj, jo më vonë se 20 ditë nga momenti i shpalljes së tyre.

13.3. Për të garantuar të zgjedhurit në vendet drejtuese sindikale në kryerjen e detyrës së tyre, përfshirë kryetarin, n/kryetarin dhe sekretarin e Këshillit Sindikal të rrethit, si dhe kryetarët e Këshillave Sindikale në shkollë, punëdhënësit i ndalohet t'i largojë ata nga puna, ose t'u ndryshojë vendin e punës, pa marrë në parë pëlqimin me

shkrim të Kryesisë së SPASH e FSASH, përveç rasteve kur vërehen shkelje të ligjit ose të Kontratës kolektive ose individuale të punës.

13.4. Drejtuesve të Seksioneve sindikale në rrethe të secilës sindikatë nënshkruese të Kontratës Kolektive, për t'u mundësuar marrjen me veprimtari sindikale, mbështetur në nenin 181, pika 7 e Kodit të Punës, u reduktohet ngarkesa mësimore javore, nga 5 deri në 10 orë në javë, si rregull, sipas numrit të anëtarësisë me kuotizacion.

Për Seksionet Sindikale në Qarqe, që kanë me shumë se 600 anëtarë, i reduktohet norma mësimore javore edhe një personi të dytë me 6-8 orë në javë.

Masa konkrete e reduktimit të ngarkesës mësimore javore për çdo drejtues seksioni vendoset me marrëveshje midis dy sindikatave dhe u njoftohet Drejtorive Arsimore Rajonale në fillim të çdo viti mësimor. Titullarët e Sindikatave Qendrore mund të anulohet në çdo kohë kërkesën e tyre për ulje të normës mësimore për ata drejtues sindikalë vendorë që nuk e justifikojnë këtë lehtësi që u kënet.

13.5. Sindikatat nënshkruese të kësaj Kontrate Kolektive njihen me të gjithë treguesit ekonomik-financiar në nivel qendror dhe lokal.

13.6. Me kërkesën e kryesive të dy sindikatave nënshkruese të Kontratës, Drejtoria Arsimore e Qytetit Tiranë i venë në dispozicion të tyre, për t'u marrë me veprimtari sindikale, nga një mësues secila për secilën sindikatë me ngarkesa mësimore javore të reduktuar, duke i ngarkuar këta mësues me jo më shumë se 12 orë mësimi në javë.

13.7. Në pajtim me nenin 181, pika 6 e Kodit të Punës, të zgjedhurit në organet sindikale në qendër e në rrethe, me ndarimin e mandatit, kanë të drejtë për t'u rikthyer në punë në profilin e tyre.

13.8. Dita e Mësuesit, 7 Marsi dhe Dita Ndërkombëtare e Mësuesve, "5 Tetori" do të jenë në të gjithë vendin ditë veprimtarish kushtuar kësaj feste.

13.9. Veprimtaritë sindikale zhvillohen në mjediset e shkollës, pa dëmtuar procesin mësimor. Seksionet dhe

Këshillat Sindikale kanë të drejtë të shpërndajnë dhe publikojnë në mjediset e shkollës, njoftime, programe, dojektiva, përfshirë Kontratën Kolektive dhe dokumente të tjera të tyre.

13.10. Kryetarëve të Këshillave Sindikale në shkollë që përfaqësojnë në shumë se 15 anëtarë, nuk duhet t'u japet klasë në kujdestari.

13.11. Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, sipas mundësive të saj, u siguron dy sindikatave qendrore, mjedise dhe paisje për zhvillimin normal të veprimtarisë së tyre, ndërsa Drejtoritë Arsimore Rajonale dhe Zyrat Arsimore të rrethëve brenda mundësive të tyre t'u sigurojnë anjente dhe paisje pune seksioneve sindikale të FSASH dhe SPASH.

13.12. Për të lehtësuar pjesëmarrjen e kryetarëve të seksioneve sindikale të rrethëve në mbledhjet e këshillave drejtuese qendrore të tyre, për 4 (katër) mbledhje në vit, Drejtoritë Arsimore Rajonale dhe Zyrat Arsimore të rrethëve, mbulojnë shpenzimet e udhëtimit dhe dietat, mbi bazën e vërtetimeve me shkrim të lëshuara nga kryesitë e sindikatave qendrore.

Neni 14 Statusi i MËSUESIT

14.1. Te dy palët bien dakord që të intensifikojnë punën e nisur për përfundimin brenda vitit të një drafti për Statusin e Mësuesit.

Neni 15 Zgjidhja e MOSMARRËVE SHJEVE

15.1. Për rastet kur ka shkelje, keqinterpretim apo keqzbatim të një ose disa neneve të kësaj Kontrate, pala e interesuar do të ndjekë procedurën e nëposhtme për zgjidhjen e tyre:

a-Të punësuarit sipas kësaj Kontrate, kur kanë ankesa, së pari duhet ta diskutojnë dhe ta zgjidhin çështjen me titullarin e institucionit në mirëkuptim dhe, kur ai e shikon të nevojshme, i shoqëruar nga Kryetari i sindikatës ku ai bën pjesë.

Vijn nga faqja 13

b-Nëse ankesa nuk zgjidhet me mirëkuptim sipas pikës 14.1 i interesuari ose sindikata i drejtchet me shkrim titullarit të institucionit, në të cilin ka lindur ankesa, brenda 30 ditëve nga momenti i paraqitjes së ankesës, duke parashtruar edhe arsyet e saj.

c-Në parashtrimin e ankesës duhet të përfshihen: emri i të punësuarit, paraqitja e fakteve, përcaktimi i nenit të shkelur në kontratë me referencat përkatëse, si edhe shkeljet e akteve ligjore ose rregullore.

d-Brenda 10 ditëve, pasi marr ankesën, titullari i institucionit komunikon vendimin me shkrim për ankesuesin.

e-Brenda 30 ditëve pasi marr vendimin e titullarit, ankesi mund ta apelojë këtë vendim tek instancat në të larta. Ai bëhet me shkrim dhe duhet të shoqërohet me kopjen e vendimit të titullarit të institucionit.

f Titullari i instancës në të lartë ose një person i autorizuar prej tij, brenda 30 ditëve komunikon përgjigjen me shkrim për të interesuarin dhe për sindikatën.

g- Kur ankesa është në nivel sindikate rrethi, procedura e mësipërme ndiqet në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, së bashku me përfaqësues të Kryesisë së FSASH dhe SPASH.

h- Nëse pas kësaj procedure, konflikti nuk gjen zgjidhje, pala e interesuar i drejtchet Gjykatës.

Neni 16

Detyrimet dhe sanksionet

16.1. Palët kontraktuese janë të detyruara të pëmbushin dhe respektojnë detyrimet që lindin nga Kontrata, duke respektuar kërkesat dhe duke zbatuar zgjidhjet që përmbajnë nenet 169 deri 172 të Kodit të Punës.

Për S.P.A.SH.

K R Y E T A R I

Bajram Kruja

16.2. Në rast të thyerjes së disiplinës në punë, dëntimit të rëndë ose të përsëritur të pasurisë së institucionit, punëmarrësve u jepen këto masa disiplinore:

- a Këshillim,
- b Vërejtje,
- c Vërejtje me paralajmërim,
- d Zbritje në detyrë deri në 6 muaj,
- e Dëshpërdolim i dëmit, në masën që vendos Gjykata, dhe
- f Largim nga puna

16.3. Në rast të thyerjes së rëndë të etikës në punë dhe të sjelljeve ekstremiste të padenja, nga ana e punëmarrësit mund të bëhet zgjidhja e menjëhershme e kontratës individuale të punës, bazuar në Nenin 153 të Kodit të Punës.

Neni 17

E drejta e aksionit sindikal dhe e GREVËS

17.1. Për arritjen e qëllimeve të tyre që janë mbrojtja e interesave dhe kërkesave sociale ekonomike të anëtarëve që përfaqësojnë, në mbrojtje të zhvillimit të reformës dhe modernizimit të arsimit, të mitjes së cilësisë së procesit mësimor, sindikatat nënshkruese të Kontratës Kolektive, si partnere të ligjshme të punëdhënësit, MASH dhe Qeverisë, do të përdorin në radhë të parë negociimin dhe dialogun social, do të bëjnë argumentimin social e ligjor të kërkesave të tyre.

17.2. Por, nëse rrugët dhe mjetet sindikale që përshkruhen në pikën 1 të këtij neni nuk do të japin rezultat, në kuptimin që nuk do të çojnë në zgjidhjen e kërkesave të parashtruara, në bazë të nenit 50, pika 1 e Kushtetutës së Shqipërisë, që garanton të drejtën e grevës dhe në bazë neneve 197, 197/1, 197/2, 197/3, 197/4, 197/8, 197/9 dhe 197/10, të Kodit të Punës, të dy

Për F.S.A.SH.

K R Y E T A R I

Xhafer Dobrush

Sindikatat Qendrore nënshkruese të Kontratës Kolektive kanë të drejtë të përshkallëzojnë lëvizjen sindikale me anë të protestave, manifestimeve deri te greva e pjesshme ose e përgjithshme.

Neni 18

Të ndryshme

18.1. Palët mund t'i bëjnë plotësim dhe ndryshime kësaj Kontrate gjatë periudhës që ajo është në fuqi, në përputhje me ndryshimet që mund të rribohin në legjislacion ose ndryshime të tjera, me pëlqimin e të dy palëve. Ndryshimet apo plotësimet do të bëhen vetëm me shkrim.

18.2. Palët mund të zgjidhin Kontratën në çdo kohë për shkak të arsyeshme të parashkuara në ligj. Për këtë është i nevojshëm njoftimi paraprak, me shkrim, zyrtarisht 3 muaj përpara. Po kështu, palët mund të vendosin zgjatjen e afatit të kësaj Kontrate tej asaj që është parashkuar në Nenin 3, por zgjatja duhet bërë me shkrim.

18.3. Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të detyrueshme për të gjithë punëdhënësit dhe punëmarrësit e nivelit të dytë, përfshirë Drejtoritë Arsimore e drejtoritë e shkollave, Prefekturat, Këshillat e Qarqeve, Bashkitë dhe Komunat si dhe Seksionet Sindikale të FSASH e SPASH.

18.4. Kontratat Kolektive të nivelit të dytë konsiderohen anekse të kësaj Kontrate dhe përfshijnë problematikën specifike vendore.

Kontrata Kolektive e Punës, hartohet në katër kopje të barazvlefshme, nga të cilat një depozitohet në Ministrinë e Punës dhe Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, një në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës dhe nga një në secilën sindikatë nënshkruese.

Për MINISTRINË E ARSIMIT DHE SHKENCËS

MINISTRI

Geno Pollo

PEDAGOGJIKASIT – NJË BREZ MËSUESISH QË MERITON MIRËNJOHJE

Një vendim i Drejtorisë Arsimore Rajonale për largimin nga puna të disa mësuesve të qytetit Shkodër na ngamoi kujtesën për brezin e mësuesve me arsim të mesëm pedagogjik.

Pavarësisht se në kohë të ndryshme dhe me objektiva e synime deri diku të ndryshme, gjithnjë është folur e shkruar për reformë në arsim. Përiudhë në intensive në arsim zor se mund të ketë patur ndonjë kontribut të lirisë, sic pati Shoqëria në gjyqin e dytë të shekullit të 20-të. Zhdukja e analfabetizimit, vendosja për herë të parë e arsimit të detyrueshëm, themelimi i arsimit të lartë, masivizimi i shkollave të mesme etj., janë disa nga momentet kulturore të reformave në atë periudhë.

Nuk është qëllimi i këtij shkrimi të merremi me të gjitha ato momente, por të evidentojmë disa momente që realizoi me shumë sukses bezi i mësuesve pedagogjikas. Kur kërkohej zhdukja e analfabetizimit, realizimi i arsimit të detyrueshëm 4-vjeçar, 7-vjeçar, 8-vjeçar dhe purë kulturore me fshatin, deri në vitet 70-të, dihej se peshën kryesore do ta përballonin pedagogjikasit. U shpërndanë në çdo fshat e qytet të Shoqërisë. Pa zhumë, në heshtje e ia dolën me sukses. Me një punë intensive, me vuajtje, me kushte të mjerueshme e sakrificat deri në flijim. Duke parë historikët e shumë shkollave dhe tregimet e vetë atyre, të duket e pabesueshme se si një mësues përballon mesim paradreke, mesim pasdreke, kurse kundër anal-

fabetizimit dhe drejtues i aktiviteteve kulturore në fshat (Ministria e Arsimit ishte një me atë të Kulturës).

Jani në fillimet e viteve 70-të dhe suksesi në arsim ka qenë emocionues. Shoqëria e 90% analfabetëve ka realizuar në të gjithë vendin arsimin e detyrueshëm 8-vjeçar. Shpërblimi: disa mësues u pushuan nga puna, jo për doli në punë, por për biografi, disa u burgosën për veprimtari antiqësore. Fillon shtegtimin në çdo pëllëmbë të tokës sonë Don Kishoti. E vështirë për intelektualin mësues ta përballonte. Tjeter thuhej, tjetër këhej, tjetër anihet. Individualizimi, humori, ironia deri në nivelin e sarkazmës mbushnin kohën e lirë të mësuesve pas mesit të viteve 70-të. Në kulmin e asaj periudhe të vështirë mësuesit me arsim të mesëm pedagogjik realizuan në ciklin e ulët programin e ri të matematikës.

Ka qenë revolucion në matematikë dhe këta mësues treguan, jo vetëm përkushtim, por nivel të lartë metodik e shkencor. Niveli i mësuesve në lëndën matematikë në fundin e viteve 80-të për arsimin e detyrueshëm nuk do të arrihet për shumë kohë. Sa do të ishte ritur rendimenti po të mos ishte shpenzuar energji jo në kahun e duhur.

Për 17 vjet, (1990-2007), përpjekje të shumë specialistëve, ecuria e këtyre reformave ka qenë me ritme të ngadalta. Kjo për shkak politike. Disa politikanë që kanë drejtuar këto reforma

duket kanë formimin e viteve 80-të sipas atyre cilësive që theksuan më lart. Por mësuesit e kanë kuptuar shpejt dhe qartë statusin e tyre në këtë fazë të reformimit të arsimit. Edhe në këtë periudhë mësuesit pedagogjikas kanë treguar vlera të larta të mësimit dhe edukatorit. Por ky brez po e mbyll karrierën. Disa kanë dalë në pension, disa janë larguar me kohë për shkak politike, disa janë sëmurë, etj. Ai grup i vogël që ka mbetur do të largohet ndoshta parakohe. Kërkesë e kohës. Rrjedhim i një logjike të ftohtë. Vlerësim moral e shpërblim i arsyeshëm e i pranueshëm. Në këtë mënyrë mund ta mbyllim karrierën ky brez mësuesish që i dha aq shumë shoqërisë në njërin nga sektorët më të vështirë. Largohet në këtë mënyrë brezi i fundit i mësuesve që flisnin bukur, shkruanin bukur, lexonin, vizatonin, këndonin, visheshin bukur etj. Këta nuk i kërkon në këto parametra, ose është e vështirë për t'i patur një individ gjithë këto parametra. Së fundi shoqëria nuk do të harrojë se ky ishte brezi që punoi në kohët më të vështira, që lartësoi figurën e mësuesit nga ana morale, njerëzore dhe metodike shkencore. Ashtu siç nuk do të pranojë të hidhet në mugë, sepse nuk do të pranin kapitullimin e plotë.

Isa Reka

Kryetar i Seksionit Sindikal të FSASH,
Shkodër

Mbrojtja e anetareve lidhet me zhvillimet progresive ne arsim

Vijon nga faqja 7

efektive, sidomos në konsolidimin e seksioneve sindikale, në riorganizimin e disa seksioneve, sidomos të disa nrethve të vogla, në miratimin e rolit të drejtuesve të këtyre seksioneve, në fuqizimin financiar, duke miratuar në mënyrë të ndryshme të ardhurat nga kutat, si edhe në forcimin e bashkëpunimit me DAR e ZA për zgjidhjen e problemeve që dalin në punën e përditshme.

Duke folur për çështje të metodes së punës, ai theksoi domosdoshmerinë që kryetaret e seksioneve t'i përgjigjan nivelit të kërkesave të kohës, të jenë konkrete dhe të kuptojnë mirë rolin e tyre si përgjegjës për situatën në seksionin përkatës. Përvija e këtyre viteve të fundit sidomos në Tiranë e Vlorë, në Skrapar e Kurbin, në Elbasan e Fier, na tregon se kur kryetari i seksionit e kupton këtë përgjegjësi dhe punon me përkushtim, duke grumbulluar

nreth vetes një grup aktivistësh të përkushtuar, punët shkojnë mirë dhe rezultatet nuk mungojnë. Duke e konsideruar gjendjen aktuale financiare të Federatës si jo të mirë, Keshilli caktoi si datë kufi për përmirësim të ndryshme, në përputhje me objektivat e caktuara për këtë vit, 15 tetorin 2007, gjë që kërkon angazhim të të gjitha strukturave të Federatës nga qendra në baze.

Duke folur për këto çështje, Sekretari i Përgjithshëm i Federatës, Stavri Liko, pasi evidentoi aktivitetet e shumta që janë zhvilluar e po zhvillohen në kuadrin e zbatimit të projekteve me Federatën Ndërkombëtare të Arsimit, EIT, me Konfederatën Holandeze të Sindikatave, FNV, me ILO-IPIC e me partnere të tjera dhe përmirësimet e bera në funksionimin e strukturave të saj, në punën me të rinjtë e grata mesuese, si edhe angazhimet për parandalimin dhe eliminimin e largimeve nga shkolla dhe të punës së famijeve, vuri në dukje domosdosh-

merinë e një angazhimi të përgjithshëm për t'i shpëruar këto aktivitete me rezultate konkrete.

Ai theksoi nevojën e sigurimit të zyrave, në bashkëpunim me DAR të qarqeve kryesore, pajisjet dhe mjetet kryesore të cilave do të sigurohen në kuadrin e projektit me FNV, si edhe paraqiti disa propozime konkrete për programin e aktiviteteve në përputhje me situatën aktuale të krijuar pas 1 gushtit.

Ai theksoi, gjithashtu, se asnjë dokument në lidhje me veprimtaritë e Federatës ose të projekteve, nuk ka humbur dhe të gjitha aktivitetet do të zhvillohen sipas programit të punës, në përjashtim të atyre që ishin planifikuar për periudhën 4 - 19 shtator, të cilat po riplanifikohen për t'u zhvilluar në vijim.

Keshilli mori vendimet përkatëse për të gjitha çështjet e diskutuara dhe kërkoi angazhim serioz e të përgjithshëm për realizimin e tyre.

Tribuna sindikale

Të reja shkencore

HEWLETT PACKARD HEDH NË TREG KORNIZËN E TIJ TË RE DIXHITALE

HP ka krijuar një kornizë për foto tërësisht dixhitale, me ekran me resolucion 800 x 480 dhe raport në kontrast 400 me 1. Kjo pajisje ka të instaluar një mekanizëm



intuitive me anë të të cilit ju mund të dëgjoni muzikën tuaj të preferuar ndërkohë që shihni albumin e fotove që zëvendësojnë njëra-tjetrën në shpejtësinë e përzgjedhur nga vetë ju.

Formati i videove që mund të shihen në këtë kornizë dixhitale është MPEG1 dhe MPEG4 ndërsa formati i audios MP3. Për sa u përket fotove mund të përdoret JPEG. Kjo kornizë është e aftë ta njohë automatikisht llojin e formatit më të

përshtatshëm për të parë fotot në cilësinë më të mirë të mundshme.

PHILIPS ÇUDIT TREGUN ME LINJËN E RE AUREA

Nëse po planifikoni të merrni një televizor plazma, me ekran të sheshtë, për dhomën tuaj të ndenjes, do të ishte e volitshme të merrni në konsideratë linjën Aurea nga Philips. Ky emër i ri për markën Philips është tërësisht High Definition dhe me tregues shokues, të tipit 3 ms kohë



përgjigje, një treshe prej 1.3 inute HDMI, 26 altoparlante të përmbledhur në rreth 20 mini drivera që ndodhen në pjesën e përparme dhe disa boxe të pajisura me amplifikator. Ndriçimi i figurës është 550cd/m2 dhe raporti i kontrastit qëndron rreth 1,200/8,000 me 1.

Detajet për çmimin ende nuk janë

deklaruar, por jemi në dijeni se linja e re Aurea do të bëjë një bum të madh në Europë këtë muaj, kur të dalë në treg, duke filluar me modelin 423. Në çmim përfshihen edhe kornizat Ambientlight për një figurë me efekt më shndritës. Çfarë prisni, filloni të kurseni!

KI NEMAJE E GUZHINËS

Edhe mamatë kanë nevojë për pak pushim, prandaj pse mos të marrim në konsideratë CTV 4845 nga AEG që është shfaqur për herë të parë në panairin e vitit 2007 në Berlin? Ky monitor LCD 7" mund të vendoset në guzhinën tuaj duke bërë të mundur që të shihni filmin e preferuar, ndërkohë që po përgatitni diçka për të ngrënë për familjen tuaj.



Nuk është shumë e sigurt se sa të ndjeshme janë pajisjet elektronike të kësaj DVD-je ndaj vajrave të guzhinës. Ndoshta do të duhet të jeni të përgatitur të fshini shpesh ekranin LCD për të patur një figurë të pastër.

Keshilla praktike

DHJETË MËNYRA PËR TË PRISHUR NJË INTERVISTË PUNE

Ka shumë informacione në lidhje me atë që duhet të thoni dhe të bëni gjatë një interviste pune. Por, mund të jetë po aq e rëndësishme të dini edhe atë që nuk duhet të bëni ose të thoni. Është thelbësore të kuptohet që ajo që thuhet mund të komunikohet, jo vetëm nëpërmjet fjalëve, por edhe veprimeve.

1. Shkoni vonë në një intervistë

Me këtë tregoni që nuk ju intereson aspak vendi për të cilin aplikoni.

Është e këshillueshme që të arrini të paktën 15 minuta para orarit të takimit, në mënyrë që të keni kohë të përmbledhni edhe një herë mendimet tuaja në mendje, të rishikoni shënimet dhe, gjithashtu, të bëni përshtypje të mirë.

2. Tregoheni të pasjellshëm me sportelisten

Kjo do të thotë që është e vështirë për të krijuar marrëdhënie pune me ju.

Sportelistët e kanë për detyrë të jenë sytë dhe veshët e kompanisë. Përveç kësaj, nëse arrini që të pranoheni në atë punë, një ditë mund t'ju nevojitet bashkëpunimi me ta.

3. U përgjigjeni pyetjeve me përgjigje klishe, aspak origjinale dhe spontane

Me këtë tregoni që nuk keni asgjë të veçantë nga shumica e të intervistuarve të tjerë.

Shfaqja e perfeksionizmit dhe ambicies së tepruar për veten tuaj është e sigurt që nuk do të bëjë përshtypje të mirë. Përgatitni që më parë përgjigjet për pyetje të mundshme për të evituar përgjigjet e zakonshme.

4. Të mos bëni pyetje

Kjo tregon që ju nuk jeni shumë i interesuar për kompaninë. Intervista duhet të jetë një bashkëbisedim nga të dyja palët, për të përcaktuar nëse jeni personi i përshtatshëm për kompaninë dhe nëse kompania ju përshatet. Përdoreni intervistën për të mbledhur sa më shumë informacione në lidhje me pozicionin për të cilin po aplikoni.

5. Pyetjes standard "Ç'mund të na thoni për veten tuaj" i përgjigjeni: "Ç'doni të dini ekzaktesisht"

Kjo do të thotë se ju nuk keni asgjë të veçantë që t'i ofroni kompanisë.

Në këtë moment keni mundësi të drejtoni bashkëbisedimin drejt fushave që ju interesojnë dhe ku shkëlqeni vertet. Mos e humbisni këtë shans duke treguar që nuk keni asnjë cilësi të veçantë për të cilën do t'ju pëlqente që drejtuesit e firmës të ishin në dijeni. Këshillohet të mos fillohet biseda duke treguar vendlindjen pasi është më mirë të fokusoheni në karrierën tuaj.

6. Përdorni një gjuhë të papërshtatshme

Ajo që tregoni me këtë është se jeni jo profesional dhe nëse kjo duket që gjatë intervistës, mund të imagjinohet se si do të ishte në zyrë, në rast pranimit të aplikimit tuaj.

Edhe nëse janë fjale deri diku të pranueshme dhe popullore nuk duhet të ketë vend për to gjatë një interviste pune.

7. Flisni keq për punëdhënësit që keni patur më parë

Me këtë tregoni që ju nuk jeni aspak i rezervuar dhe do të ishit në gjendje të zbuloni çdo informacion të brendshëm të kompanisë.

Nëse jeni larguar i mërziur nga puna juaj e mëparshme, para intervistuesit duhet të vlerësoni thjesht këtë eksperiencë. Nuk duhet të jeni negativ.

8. I kërkoni intervistuesit tuaj të mos kontaktojë me punëdhënësin e mëparshëm

Me këtë tregoni që keni diçka për të fshehur. Edhe nëse nuk shkonit mirë me shefin tuaj, mund të përmendni dikë tjetër si referencë.

9. Ekgazjeroni kur flisni për arritjet dhe kredencialet tuaja.

Duke thënë këtë, tregoni se nuk jeni aq i mirë dhe keni nevojë të gënjeni për t'u dukur i përshtatshëm për pozicionin për të cilin aplikoni.

Një intervistuesit i aftë mund t'i dallojë me lehtësi cilësitë tuaja të mira dhe eksperiencat tuaja. Flisni për kualifikimet tuaja me vetësiguri. Nuk duhet të jeni Superman për t'u punësuar: thjesht duhet të jeni i përshtatshëm për punën.

10. Nuk falenderoni intervistuesin tuaj.

Kjo tregon që nuk keni kulturë.

Të harrosh të falenderosh intervistuesin për kohën që ju kushtoi mund të rregullojë edhe intervistën më të pasuksesshme.

Përgatiti faqen Eriona Vargjeli